



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 150, datë 30.09.2025**

**PËR**  
**MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUTIT TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT**  
**“ANSIG” SH.A. DHE MIRATIMIN E PJESËMARRJES SË MËTEJSHME**  
**INFLUENCUESE**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, neneve 48 dhe 57, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Rregullores nr. 138, datë 21.12.2015 “Për miratimin ose refuzimin e ndryshimeve thelbësore të statutit të shoqërisë së sigurimit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

- 1. Miratimin e ndryshimit të nenit 4, të statutit të shoqërisë së sigurimit “Ansig” sh.a., si rezultat i ndryshimit të strukturës aksionare nga dhurimi i aksioneve, me përmbajtje si vijon:**

Neni 4

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 980,058,000 lekë (nëntëqind e tetëdhjetë milion e pesëdhjetë e tetë mijë lekë), i ndarë në 98,006 aksione të zakonshme me vlerë nominale 10,000 lekë secili, sipas strukturës si më poshtë:

Në vlerë nominale

Numri i aksioneve	98,006
Vlera nominale e aksioneve	10,000
Piro Angjeli	88,205
Edlir Ruka	9,801

Në lekë

Piro Angjeli	882,052,200
Edlir Ruka	98,005,800
Kapitali i Shoqërisë	980, 058, 000

Në % pjesëmarrje

Piro Angjeli	90 %
Edlir Ruka	10 %

- 2. Miratimin e pjesëmarrjes së mëtejshme influencuese të aksionarit z. Piro Angjeli.**
- 3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimin e këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR**

**Saimir TOLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**Mimoza KAÇI**